


## Prizren 20. 10. 2023

Për përrurimin e këtij libri u angazhuan Institucione e Shoqata private të vendit me aktivizimin e intelektualëve e specialistëve të etnokulturës, artistëve e veprimtarëve, lexuesve e botuesve duke programuar zbërthimin e parashtrimeve, analizave, përshkrimeve, opinionëve dhe punimeve shkencore për personalitete e profile, shoqëri kulturore e festivale në qytetet:



## *Nga biografia e Esat Rukës*

Esat Ruka është lindur në Mat më 10 mars 1951. Ai është artist shumëplanësh, rruga e të cilit nis që në fëmijëri.

Është producent i 6 albumeve muzikore më këngë folklorike e popullore.

Gjatë një periudhe 50-vjeçare si specialist e drejtues i kulturës ka ngritur e drejtuar disa ansamble folklorike.

Në vitet 2006-2013 ka qenë Drejtor i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike.

Në vitet 2008-2013 ka qenë Anëtar i Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Shpirtërore.

Në vitin 2009 ishte Sekretar i Komitetit Organizator dhe Drejtor i Festivalit Folklorik Kombëtar Gjirokastrë.

Ka shkruar artikuj e punime studimore dhe ka qenë i ftuar në shumë emisione radiotelevizive për probleme të trashëgimisë kulturore shqiptare.

### **Botime të autorit:**

1. Monografi: Mati vështrim etnomuzikor- gjurmime, studime dhe vlerësime. Në vitin 2009
2. Broshurë: 45 vjet Orkestrinë me instrumente tradicionale. Në vitin 2013
3. Festivali Folklorik Kombëtar- Gjirokastrë 2009. Në vitin 2015
4. Dukuri, Fenomene Kulturore, Profile Krijuese. Në vitin 2023.

Është Laureat i Festivaleve Folklorike

### **Mban Titujt:**

- “Qytetar Nderi” i Matit
- “Mjeshtër i Madh”
- “Ambasador i Paqes”



Tryeza drejtuese e promovimi të librit në Prizren



### Kadri Skeja

**Z.** K. Skeja i uroi autorit mirëseardhjen të librit në mjediset e Shoqërisë “Agimi” dhe bëri një panoramë të bashkëpunimeve të Q.K.V.F. nën drejtimin e z. Esat Ruka, ku theksoi se miku që kemi sot midis nesh është një kuadër, njeri dhe artist dhe studiues shumë i njohur për banorët e Prizrenit. Festivali që mbahet sot “Kënga qytetare na bashkon në Prizren” është ideuar nga ky mik e drejtues i mirënjohur. Ai është ndër të rrallët që krijon muzikë e këndon, por edhe shkruan. Ne nuk duhet të harrojmë se, vërtet njihemi si populli më i vjetër i Ballkanit, por nuk kemi një “Nobel” si shkrimtar. Prandaj duhet punuar, por edhe duhet dokumentuar e botuar. Mirënjohje autorit për modelin që ofron dhe suksese në angazhimin e tij krijues.



### Prof. Dr. Zymer U. Neziri, Epikolog

**E** njoh Esatin që në vitet 2006 si drejtues zyrtar i Festivaleve folklorike në Shqipëri. Ai e ka shtrirë bashkëpunimin në të gjitha trojet shqiptare dhe ka mbetur në kujtesën e artistëve e drejtuesve, studiuesve e botuesve si një mik i rrallë e kulturolog i çmuar. Me krijimtarinë e mirënjohur për temën e Kosovës zë një vend nderi si artist në gjithë hapësirat shqiptare dhe nuk konsiderohet vetëm Qytetar Nderi i Matit, por mendoj i gjithë shqiptarisë. Në vitin 2012 në punën tonë për mbledhjen dhe botimin e Epsit të Kreshnikëve, Esati ka qenë shtylla e rëndësishme e punës për Shqipërinë e veriut dhe ka bërë një punë lavdëruese. Puna e tij studiuese dëshmohej edhe në librin që po përurojmë sot, e cila ngërthen një panoramë të gjerë e të thellë të trashëgimisë dhe personaliteteve të mirënjohura të kombit tonë. I uroj autorit suksese në botime të tjera, po kaq të arrira.



**Dr. Behar Arllati, Etnomuzikolog**

Undjeva i nderuar, kur Mjeshtri i Madh, Esat Ruka, më ofroi përgjegjësinë e mbajtjes së një kumtese në përrimin e librit këtu në Prizren. E lexova menjëherë librin: “Dukuri, fenomene kulturore, profile krijuese” të autorit dhe pashë vëzhgimet dhe impresionet e tij për një galeri figurash të mëdha të kulturës kombëtare, disa prej të cilëve nuk rrojnë, por rron dhe ndriçon kontributi i tyre i vyer si studiues e interpretues, drejtues e botues, por edhe figura të tjera po kaq të rëndësishme që janë jashtë sektorit të artit e të kulturës.

Edhe pse u referohet më së shumti emrave nga treva e tij e Matit, autori trajton një galeri të shumë emrash nga hapësira gjithëshqiptare dhe shkruan për ‘to pa paragjykime, me shumë sinqeritet e dashuri. Të gjithë lexuesit, madje edhe profesionistët do të gjejnë diçka të re, të cilët nuk e njohin edhe për faktin se autori e ka shtrirë përfshirjen në libër të hapësirës gjithkombëtare dhe kjo është një veçanti e suksesshme e këtij libri. Mjafton që njerëzit të shohin emrin e artistit të këngës, valles, instrumentit dhe të sjellin në mendje krijimet më të spikatura të tij si për: Haziz Ndreun, Ndue Shytin, Imer Nelin, Rexhep Çelikun, Xhevat Fanën. Sikur vetëm fotot e tyre të panjohura të kundrojnë si ajo e “valles së Njalës”, Lirie Rashës, Festivalit “Hasi Jehon” e “Kënga qytetare na bashkon në Prizren” dhe njerëzit menjëherë afektohen nga përfytyrime estetike me vlerë.

Me numrin e madh të personazheve që përmban si dhe me numrin e vëzhgimeve rreth aktiviteteve

të ndryshme artistike e promociionale, kjo vepër meriton të quhet një mini leksion, pasi kushdo mund të gjejë detaje të vogla që kujtojnë bëmat e mëdha të këtyre gjigandëve të muzikës e folklorit por jo vetëm, të dhëna fillestare që mund të jenë shtysë për ndonjë punim shkencor apo edhe fotografi ilustruese shumë sinjifikative.

Do shtoja dhe një aspekt tjetër të vlerës së kësaj veprë. Shikuar nga aspekti estetik, në këtë vepër, problemet, rastet, aktivitetet, vështirësitë, këndvështrimet dhe pikëpamjet e këtyre figurave kanë të bëjnë me fenomenin kohor të ballafaqimit të së vërtetës ndjesore në përmasat e tyre reale, metafizike, me doktrinat negative të imponuara nga përshtjellimet teorike anti-religjioze dhe antihumane, si bazë kushtëzuese e tipit “e ke prirjen për art ose s’e ke” me ç’rast dalin në pah doktrinat të cilat, në funksion të poleve të kundërta gravitacionale, kanë orientuar, diktuar e madje edhe qeverisur në përgjithësi mendimin estetik që, kushtimisht, do duheshe të jetë i lirë.

Për më tepër, në këtë rast kemi të bëjmë me luftën në mes të

(1.) mospranimit të aftësisë së shprehjes artistike me ç’rast arti do të kishte semantikën e vet arbitrare e të lirë ndonëse të pakodifikuar universalisht, dmth jokonvencionale dhe

(2.) të mohimit tërësor të potencialit të organizimit artistik dmth, hiq ndonjë rast shumë sporadik, tërësia artistike nuk përfaqëson veçse një humoreskë “magjepsëse” pa ndonjë domethënie apo sens të mirëfilltë artistik aq sa, në aspektin semiotik, madje është diskutuar edhe për mundësinë që arti (në këtë rast Muzikor-tingullor) të përfaqësojë një tipologji mediumesh “sui generis” dhe në këtë mënyrë të ketë një gjuhëshmëri monoplane, e pajisur me planin shprehës muzikor por jo edhe me atë përmbajtësor. Pra, një mospranim radikal të prurjeve artistike dhe kundërvënien përmes doktrinës së formalizmit autoritar.

Shfrytëzoj rastin ta përgëzoj zotin Esat Ruka, Mjeshtër i Madh, për këtë vepër me interes duke i dëshiruar shëndet dhe edhe shumë vepra të tjera të tilla me interes të përgjithshëm.



**Prof. Dr. Sedat Kuçi,  
Këngëtar, Istrumentist**

**E**njuh Mjeshterin Ruka që në vitin 2008, kur “Agimi” ishte pjesë e festivalit të këngës qytetare të drejtuar prej tij. Që nga ajo kohë miqësia jonë është konsoliduar për arsye të interesimit të jashtëzakonshëm të këtij artisti dhe drejtuesi për punën dhe trashëgiminë kombëtare, për hapësirat dhe seriozitetin që z. Esat u ka dhënë zhanreve të folklorit shqiptar nëpërmjet Festivalëve, tryezave, medias dhe qarkullimit të këtyre vlerave. Uroj që ky libër shumë i rëndësishëm për çdo lexues, sidomos për studentët dhe specialistët e kulturës, të shkojë pranë tyre nga i cili do të mësojnë shumë për personalitetet e artit të kombit, për profilet të veçanta të tyre dhe fenomenet artistike që kanë bërë të mundur ruajtjen, qarkullimin dhe zhvillimin e kulturës në hapësirat gjithëshqiptare.



**Autori ESAT RUKA**

**E**kisha obligim ta bëja të parin përurim në ShKA “Agimi” Prizren për tre arsye kryesore: **Së pari;** Im atë në vitet 1941-43 ka qarkulluar si ushtarak në viset shqiptare të Vilajetit të Shkupit.

Dhuntitë e tij të interpretimit në kangën tradicionale dhe rreshtimi i tij në odat tuaja malësore me këngëtarë të shquar të Kosovës, ka ndikuar thellë në mësimin e historinë tonë kombëtare. Ai thoshte me krenari se, historia e kombit tonë me ngjarjet më të mëdha dhe burrat më të shquar e kanë zanafillën dhe namin në Kosovë. Pra, ai ka qenë inspiruesi i parë dhe më i rëndësishëm i angazhimit tim krijues kushtuar të mëdhenjve Isa Boletini, Bajram Curri, Ibrahim Rugova, Mark Krasniqi, heroit Sali Çekaj, etj gjithsej 12 krijime e interpretime si kantautor.

**Së dyti;** Kam kryer Normalen e Elbasanit, ku shumë bij kosovarësh ishin studentë të atij institucioni Universitar për kohën, të cilët u bënë shkëndijat e çeljes së shkollave shqipe në këto anë.

**Së treti;** Gjatë periudhës kur unë drejtoja QKVF në ridimensionim të politikave kulturore të qeverisë Berisha, pjesa shqiptare e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut jo vetëm kanë qenë pjesë e tipologjive konkurruese në shumë qytete të Shqipërisë ku organizoheshin Festivale, por e kanë paraqitur artin popullor, duke u bërë shembull për disiplinë e origjinalitet të këngës, valles, veshjeve tradicionale në zbatim të kriterëve të dërguara nga institucioni organizator. Pikërisht këto kanë qenë disa nga arsyet që unë i mendova si avantazhe meritorë të ndjeshmërisë dhe personale dhe institucionale. Ju falenderoj për pritjen dhe mendimet tuaja, fjalët vlerësuese e inkurajuese që u thanë për mua dhe librin tim, të cilin tashmë e keni në dorë dhe në bibliotekat tuaja publike.



**Mat - 25. 11. 2023**

*Përrurimi i librit u organizua në mjediset e -ish Universitetit "Nëna Mbretëreshë Geraldinë" nën drejtimin e Klubit të Poezisë Pjetër Budi" dhe bibliotekës së qytetit me praninë e dhjetra mësuesve, punonjësve të kulturës e drejtuesve vendor, lexuesve e*



*miqve të autorit. Veprimtarinë përruese e drejtoi z. Hamdi Hysuka, gazetar e poet, kryetar i atij Klubit, i cili duke iu referuar kurrikulës së autorit të librit, evidentoi disa nga kulmet e tij si artist, krijues, drejtues e studiuës.*



### Ali Hysnelaj, -ish Drejtor i Q. Kulturore

**A**li Hysnelaj lexon parathënien e librit shkruar nga Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaj, akademik emeritus. Midis të tjerave akademiku thekson në shkrimin e tij të gjatë e analitik se: Libri i Esat Rukës "Dukuri, Fenomene Kulturore, Profile Krijuese", i shkruar me dije e dashuri meriton të vlerësohet me kujdes, pasi autori priret nga e mbara e paraqitjes së vlerave dimensionale të trashëgimisë shqiptare dhe personaliteteve më të shquara të kësaj trashëgimie si një drejtues me karrierë të gjatë e kulturolog i pasionuar.

**Aliu evidenton se:** Ky libër është i shkruar në formën e një miniskedari që të jep mundësinë të zgjedhësh atë që të intereson më shumë për emra të shquar të studimeve, veprimtarëve e artistëve me një shtrirje kohore dhe gjeografi të madhe të zhvillimit të aktivitetit krijues e veprimtarive të mirënjohura të artit popullor. Libri është një ndihmesë serioze për këdo që mëton të njihet me vlerat kombëtare, por edhe në disa nga shkaqet e pengesave që solli platforma politike e një sistemi, i cili ngushtoi apo tjetërsoi jo pak vlera kombëtare të veprimtarëve, të cilët vinin nga një biografi "e përshtëshme" me sistemin e diktaturës komuniste.




### Bajram Canameti, Poet, Publicist

**E**çmoj si një enciklopedi për kulturën e librin e shkruar me një gjuhë të pasur e të pastër, stil të ëmbël, e veshur me fantazi krijuese dhe ndriçuar me një kolorit figurativ të këndshëm që të shijon, të impresionon e të frymëzon.

Ai me profesionalizëm dhe sinqeritet, me fisnikëri e mjeshtri artistike, duke mbajtur vulën e një njeriu ekselent, gërsheton realen me imagjinatën duke na sjell figurat emblematiche të kulturës kombëtare. Autori mbetet një kurorë hyjnore në piedestalin e historisë dhe kulturës kombëtare, duke vënë detyrën për gjeneratat e ardhshme për ti ruajtur e mbrojtur me pastërti identitetin kombëtar të tyre.



**Isuf Çipi:** Esatin e njohim si artist por kur merr penën dhe shkruan, ai është dy herë artist.



**Lindita Doda, Poete,  
N/Kryetare e Klubit "P. Budi"**

Libri i ri, i katërti në rradhë i Esat Rukës është i organizuar në 6 kapituj, i cili sjell në vëmendjen e lexuesve shumë prej vlerave krijuese e studiuese të personaliteteve të etnokulturës të cilat autori i quan AMANETE.

Autori ia ka dalë që amanetet e personaliteteve shkencore e drejtuese dhe profileve të spikatura të krijimtarisë e interpretimit artistik, tua japë lexuesve shqiptarë nëpërmjet gjurmimeve, studimeve, veprimtarive të drejtuara prej tij, respektit, sinqeritetit e përkushtimit ndaj punës dhe profesionit, si një intelektual me vision të qartë e të thellë me dashuri dhe kopetencë profesionale.

Libri fillon me dy personalitete të mëdha si Ramadan Sokoli dhe Metju Aref, dy shkencëtarë të albanologjisë dhe historisë, e zhvillon e pasuron e përndrit botimin e tij special me shumë emra personalitetesh të krijimtarisë e drejtimit të kulturës si në zonat rurale dhe urbane shpeshherë të stolisur me vargje krijuese, pse jo edhe me karakter filozofik e figura të pasura letrare dhe arin ta mbyllë me dy shkrime kushtuar problematikave të gjallërimit të jetës artistike në shkollë, pra punës me talentet e reja, e cila mbetet njëra nga shtyllat kryesore të politikave të shtetit dhe shoqërisë në ruajtjen, zhvillimin dhe qarkullimin e vlerave të identitetit kombëtar.

Autori me mençuri përzgjedh disa nga vargjet e krijuesve në raportet midis epikës dhe lirikës, vargje të cilat ngrejnë në pedestal historinë e

kombit, por edhe ndjesitë e shpirtit lirik të një populli që edhe pse drejtohet keq nga qeveritë e veta, ruan vitalitetin për jetën, ushqen pasionin për të bukurën, ndriçon sakrificën për vepra sublime.

E veçantë për librin mendoj se mbetet edhe simbolika folklorike e numrit të faqeve të këtij libri. Ai mbyllet me numrin 333 si një opus krijues i hapësirave kombëtare


E veçantë e autorit është se ai, si njëri nga drejtuesit e veçantë të kulturës, i ka vënë detyrë vetes që këto amanete t'i lerë trashëgim për gjeneratat. Libri më bëri shumë përshtypje jo vetëm si format cilësor botimi, por edhe si strukturë akademike në përmbajtje. Mendoj se libri është për nivelet e lexuesve të pasionuar, por më së shumti për nivelet universitare me kriteret e tipologjive artistike, përfaqësuesve të saj, gjuhës e stilistikës, figurave letrare e referencave të shumta. Paraqitja interdisiplinare e zhanreve dhe llojeve të artit popullor, konkluzionet dhe analizat e ballafaquara me kriteret serioze dhe ilustrative dëshmojnë seriozitetin dhe forcën e argumentit shkencor të autorit.

Libri do të mbetet si një ndihmesë serioze e referentëve që do të guxojnë të futen në hullitë e botimeve të etnokulturës shqiptare.

Suksese Mjeshtrit Esat Ruka për këtë kontribut madhor për trashëgiminë kulturore kombëtare.



Pamje nga promovimi i librit në Mat



### Baftja Çera: Specialist kulture

**K**ur punon me një njeri për 15 vite me rradhë, padyshim ke çtë thuash me vërtetësi e respekt. Do ta ndaja në tri grupime kontributin e këtij njeriu e kuadri të mirënjohur.

Esat Ruka është artist, interpretues e krijues i mirënjohur. Unë e kam konsideruar njërin ndër kantautorët më të mirë geg.

Në profilin si drejtues e kulturolog unë kam patur fatin të punojmë së bashku edhe me kolegë nga Mati në njërin nga institucionet kryesore të kulturës, ku ai me përkushtimin dhe aftësitë profesionale e drejtuese ka ridimensionuar dukshëm e me dinjitet punën në QKVF, duke kulmuar me Festivalin e 2009 në Gjirokastrë. Ai Festival është evidentar si më i miri në pikëpamjen e disiplinës së prurjeve dhe organizimit të tij. Suksesi i atij Festivali lidhet plotësisht me drejtorin organizativ që quhet Esat Ruka.

Referuar librit të ri të tij mjafton të nisemi nga titulli, ku ai cilëson dhe analizon me emra të përveçëm të kulturës kombëtare "Dukuri, fenomene, profile", ne duhet të jemi të vemendshëm për të kuptuar thellësinë e pjekurisë së tij profesionale, filozofinë në të shkruar dhe përpjekjet e tij për të futur koncepte të reja e ide të rëndësishme e të guximshme në sektorin e trashëgimisë kombëtare.



Ing. Mehmet Rami

**E**njuh gjithë jetën si artist në shpirt e në performancë, që Mati krenohet me të. Kur dëgjoj këngën kushtuar Isa Boletinit unë ngrihem në këmbë. Është nderim për Matin një figurë e tillë.



Renato Totraku, Mësues i Historisë


**E**njuh Xhaxhi Esatin nëpërmjet krijimtarisë së tij, nëpërmjet prindërve që e adhurojnë por kryesisht dua të përcjell repektin dhe mirënjohjen e një studiuesi tjetër matjanë që quhet Ferit Këputa, i cili thotë se mosha bën të veten, por Esat Rukën do ta kujtoj me mall dhe respekt të madh. Ai është një ndër njerëzit e veçantë matjan. Respekt dhe sukseste të mëtejshme.



### Ardian Ruka, Mësues i Historisë

**E**sat Ruka është një anëtar i nderuar i fisit tonë, i cili gjithnjë ka qenë i thjeshtë e modest në marrëdhëniet me ne. Ai nuk mungon asnjëherë në sebetet familjare në fshat e sidomos në fisin tonë. Ne

jemi krenar për të. Ai është krenari jo vetëm e fshatit por e gjithë Matit. I urojmë sukseste në jetën e tij. Falenderoj të gjithë miqtë dhe kolegët për fjalët e sinqerta që adresuan për këtë njeri të rrallë e të mire të fisit tonë.



Tryeza drejtuese e promovimi të librit

## Në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave

Tiranë  
03.11.2023

Morën pjesë studiues e kulturologë, lexues e studentë, botues e miq të autorit. Veprimtaria përuese u mbajt nën logon e Qendrës Shqiptare të Studimeve letrare “P. Budi”, me drejtor studiuesin Behar Gjoka. Gjoka moderon përurimin e librit duke falenderuar për pjesëmarrësit për praninë e tyre duke njohur auditorin me programin e përurimit duke prezantuar referuesit e nderuar.







### Prof. Dr. Gj. Shkurtaj, Akademik Emeritus

Në njësinë e kulturologëve, që kanë drejtuar sektorë a drejtori të institucioneve kulturore e artistike qendrore e në Ministrinë e Kulturës, jam njohur edhe me zotin Esat Ruka. Ndryshe nga shumë kulturologë të tjerë profesionistë, është jo vetëm i arsimuar dhe i profilizuar për kulturë, po është edhe artist, këngëtar i njohur brenda e jashtë Shqipërisë, me koncerte e publikime disqesh e CD të suksesëshme.

Libri më i ri z. Esat Ruka, dëshmon së pari, punën vullnetmirë e të mbështetur në synime të mbara, i nxitur nga frymëzimi e dashuria për artin dhe njerëzit e kulturës kombëtare. Libri është shkruar me dije e me dashuri, me njohje të mirë të shumë prej personaliteteve të fushës së kulturës e folklorit të trevave shqiptare mbrenda Republikës dhe të hapësirave jashtë saj në trojet shqiptare e në vende të ndryshme të Evropës e më gjerë.

Libri i tij me titullin “Dukuri, Fenomene Kulturore, Profile Krijuese” është një libër i vlefshëm, me hapësirë të gjerë prurjesh nga veprimtaria e gjatë e autorit si drejtues e kulturolog, po mbi të gjitha si njeri i përkushtuar në kuptimin e gjerë të fjalës.

Ky është një libër, ku gërshetohen natyrshëm objektiviteti i parashtrimit dhe i vlerësimeve për ngjarje (evente) e figura të mëdha të kulturës shqiptare, me dashamirësinë dhe mëtimin e rëndësishëm për t’ua vënë në dukje vlerat e ndihmesat, si atyre që i kanë fitur e gëzuar titujt e nderimet, ashtu edhe jo pak të tjerëve që, për arsye “biografike” ishin mënjanoar krejt nga skena, ose ishin lënë në hije.

Në libër jepen një galeri e madhe personazhesh të artit e të kulturës, si profesor Ramadan Sokoli, muziktar e etnomuzikolog i shquar, për të cilin au-

tori shkruan me hollësi e me njohje të mirë të gjithë veprimtarisë, po edhe për figurën e personalitetin e tij, pak të thuash të veçantë. Me dashamirësi e nderim të madh shkruan për studiuesin Mathieu Aref – (“Naim Frashëri i Artë”), duke ndriçuar shumëçka nga hulumtimet e studimet e tij interesante për vlera të shqipes së hershme që dëshmojnë lashtësi e burimorësi të etnosit shqiptar e të shqipes, që zoti Ruka mendon se meritojnë të shikohen më mirë nga qarqet albanologjike. Shkruan për Alush Hamidin e Lefter Çipën, “princin” e këngës polifonike labe, duke bërë portretizime shumë të qëlluara. Mund të themi se libri i Esat Rukës, në fakt, jep në formën e zërave enciklopedikë një njohje të shumë prej figurave të rëndësishme, si hartues tekestesh të këngëve popullore e të kultivuara, si Gjokë Beci, një emër i nderuar si poet e këngëshkruar, apo për Ali Mulën “Mjeshtër i Madh”, paraqet mjaft gjerë e me të dhëna interesante figurën e Dilaver Kurtit, studiuesit, të cilit punën e dituritë e mëdha si historian e njeri i penës ia shfrytëzonin, duke i ngarkuar hartimin e fjalimeve që u duheshin drejtuesve vendor të kohës, por nderin dhe nderimin që i takonte nuk e gëzoi asnjëherë. Me shumë dashuri dhe me vlerësim meritot paraqet në libër figurën e Haziz Ndreut “Nderi i Kombit”, po ashtu edhe për krijuesin e studiuesin Zejadin Ismajlin nga Kumanova.

Një vend me rëndësi zë në libër “Eposi i Kreshnikëve si monument i etnokulturës shqiptare”. Ka aty ide e mendime të autorit të shprehura në përhëndetje të ndryshme, ku ai ka sjellë ndihmesën e tij në diskutimet dhe vlerësimin e kësaj trashëgëmie të rëndësishme etnofolklorike.

Në vijim, në libër jepen në krah të sytha të mëvetëshëm, shtjellime e paraqitje për disa prej emrave të mirënjohur si rapsodët Pjetër Matusha, Dervish Shaqja, Demush Neziri, Ndue Shtyi “Nderi i Kombit”, Mark Gjoka “Mjeshtër i Madh”, Naim Plaku “Qytetar Nderi” i Peshkopisë, Viktor Paloka “Mjeshtër i Madh”, Frrok Haxhia “Artist i merituar”, Qytetar Nderi i Pukës; piktori Agim Dervishi; Gjon Frroku “Mjeshtër i Madh”, nderi i qytetit të Lezhës dhe i Klinës, Kosovë. Kur shkruan për artistin Ymer Neli, shpaloset gjithë madhështia e këtij mjeshtri të mirënjohur, si një data bazë e orkestrinës së famëshme të Matit dhe si pasionant e vullnetmirë në punën me talentet e reja në Qendrën Kulturore të Fëmijëve në Burrel.



\*\*\*\*\*

Në libër, autori, si artist pjesëmarës, po edhe si përfaqësues zyrtar në veprimtari të ndryshme artistike, mbrenda e jashtë Shqipërisë pasqyron marrdhënie artistike e punë të çmuara studimore. Kështu, në studimin e titulluar “Vështrim i thellë etnomuzikor i SHKA “Rapsha” Malësi e Madhe - Nderi Kombit”, Esati, në cilësinë e një studiuesi pasionant, paraqet, analizon dhe konkludon për prurjet e llojë-llojshme të bukurisë së folklorit në Festivalin e zhvilluar në “Vitojë të Tuzit, pjesë e Malësisë së Madhe, në Mal të Zi. Përshkrime interesante u kushton autori veprimtarive të zhvilluara në Gjermani e Austri. Veçanërisht të dhëna të bukura e të bollshme sjellë për Festivalin e XVIII Folklorik dinjitoz përtej Atlantikut, nga shqiptarët në SHBA dhe problematikat që u diskutuan në tryezë me veprimtarë të mirënjohur të artit popullor.

Një pjesë me rëndësi e librit është edhe ajo me titullin “Analiza & Opinione”, ku autori sjell shtjellime e trajtime për figurën e Pjetër Budit, si personalitet letrar e autor emblematic, analizon me kopetencë punën me instrumentat popullorë dhe ngre shqetësimin për zbehjen apo deformimin e eksponateve, mungesën e kabineteve me instrumente popullorë tradicionalë nëpër shkollat e mesme të muzikës dhe zbehjen e punës me orkestrinat, ku tradicionalisht kanë qenë pjesë e ndritëshme e skenave në festivalet tona. Autori me shqetësimin e artistit dhe kopetencën e gjurmuesit e drejtuesit jep rrugët e zgjidhjes, duke sensibilizuar deturën e organizmave të pushtetit vendor dhe institucioneve locale e qëndrore. Madje ai shkon deri në parashkrimin e shqetësimit se “Botime bëhen, por cili është qëndrimi i ekspertëve?”

Në shumë nga shkrimet e përmbledhura në këtë libër, autori me kompetencë, po edhe me dëshirën e mire, i mëshon idesë së bukur se arti dhe kultura popullore shqiptare kanë nevojë për t’u njohur, po edhe për t’u mbështetur. Vlerësoj aty, ndër të tjera, sythat me titull “Një fenomen artistik që duhet mbajtur ndezur” adresuar grupit të vajzave me çifteli në Bruç të Matit dhe se artistët janë “ambasadorë të paqes” dhe komuniteti që nderojnë më së shumti trashëgiminë tone kombëtare e prezantojnë vlerat më të qenësishme të identitetit kombëtar.

Libri mbyllet me një thënie të shkrimtarit të shquar



Pamje nga promovimi i librit në Tiranë

Ernest Heminguei:

*“Njerëzit më të mirë zotërojnë ndjenjën e më të bukurës, guximin për të ndërmarrë rreziqe, aftësinë për të thënë të vërtetën, kapacitetin për të bërë sakrificë. Janë ata që lëndohen dhe shkatërrohen më së shpeshti. Ironikisht virtytet e tyre i bëjnë ato të prekshëm”.*


Në fakt, evidentohet dukshëm në krejt shtjellimet e librit se, një ide e tillë e ka nxitur autorin për të ndriçuar sa të jetë e mundshme e më qartë edhe disa aspekte të qëndrimit ndaj personaliteteve të artit e të kulturës, natyrisht edhe në dritën e një perspektive e ideje të mbarë, që njohja e së kaluarës të shërbejë edhe si bazë për të mos i përsëritur më shtrembërimet apo qëndrimet e padrejta e sidomos mënjanimin e personaliteteve të artit e të kulturës nga e drejta e tyre e ligjshme për pjesëmarrje në jetën artistike e kulturore për motive “biografie”, si dhe, mbi të gjitha, i mëshon idesë se arti duhet të zhvillohet pa ndikimin e trysnive indoktrinuese të politikës.

Libri është shkruar bukur, me stil të këndshëm e të rrjedhshëm.

Unë, jo vetëm kujtova çfarë dija, por edhe gjeta shumëçka të bukur e që ia vlen të dihet nga lexuesit. Veçanërisht, ata që drejtojnë dikasteret a sektorët e lidhur mirëfilli me artin e kulturën, në mënyrë që të merren në konsideratë e të jetësohen mjaft prej ideve dhe mendimeve e sugjerimeve të parashtruara në të. Kur të bëhet fjalori enciklopedik shqiptar mendoj se ky libër duhet të jetë në tryezën e ekspertëve o për të shtuar disa nga emrat që përmenden në libër ose për të plotësuar diçka nga ata që njohen, por jo me cilësitë e të veçantat që sjell autori në profilet e këtyre personaliteteve.

I uroj autorit suksese të mëtejshme si artist, si krijues e si studiues i etnokulturës shqiptare.

Faleminderit, Tiranë, Tetor 2023



### Prof. Dr. Afërdita Onuzi

Me seriozitetin dhe sinqeritetin më të madh lejohem të them se libri “Dukuri, Fenomene Kulturore, Profile krijuese” është një libër që nderon jo vetëm galerinë e madhe të emrave të shquar të kombit në fushën e trashëgimisë, por më së pari nderon trashëgiminë kombëtare si një aset i vyer i kombit tonë.


Arsyet e këtij kontributi të parashtruar në këtë libër janë së pari figura shumëdimensionale e autorit Esat Ruka si një artist i mirë, një studiues i mirë dhe një bashkëpunëtor i mirë njeriu miqësor me bartësit, veçori këto të konfirmuara në veprimtaritë e zhvilluar për vite me rradhë. Në cilësinë e drejtuesit, ai i ka trajtuar artistët pjesëmarrës në festivale si njëri ndër miqtë e tyre dhe përkrahësit më të zjarrtë e më dinjitozë duke i stimuluar moralisht e duke u dhënë vendin e merituar në skenë dhe jashtë saj. Këto janë të aspektit njerëzor.

Në aspektin profesional Esat Ruka është një instrumentist i mirënjohur, një këngëtar me një zë brilant e krejt të veçantë, një studiues serioz e profesionist. Duke qëndruar afër me personalitetet që ai merr në shqyrtim, ka ditur të qëmtojë cilësi e vlera të mëdha të tyre, i ka përlytur me një seleksionim të mençur dhe ka lënë trashëgim shumëçka. Ne, edhe pse kemi punuar e jemi njohur gjatë me protagonistët e librit, nuk i kemi ditur apo nuk kemi përcaktuar objeksione për t'i arkivuar për gjeneratat që vijnë. Kjo është një punë e madhe e dobishme e cila e nderon autorin. Ka nderuar shumë prej këtyre vlerave dhe këtë e bën një njeri që di të nderojë dhe gjithmonë ka për të qenë i nderuar nga gjithë plejada e artistëve shqiptarë.

Edhe pse që në vitin 1971 kam qenë prezent në sferën e trashëgimisë kulturore, nga leximi i parë i këtij libri kam gjetur shumë gjëra, të cilat nuk i kam ditur dhe për këtë jap fjalën se do ta rilexoj e studioj me vëmendje. Esati ka shumë gjëra për të thënë, ka shumë mundësi për të lënë studime e parashtrime të vyera të sektorit, ku ai ka punuar gjatë e vëmendshëm, me vullnet e pasion të rrallë.

**Faleminderit dhe suksese të reja!**





### Aleksandër Çipa: Analist, Kryetar i Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë

Unë sot kam një emocion të veçantë, për shkak të raportit familjar me Esat Rukën dhe familjen e tij. Në kanonet shqiptare shënohet se, kur adresohesh tek çështjet e epistologjisë familjare, porositet një gjë shumë e veçantë. Në shtëpinë e miut, nuk vërehet se sa i ndezur është zjarri, por se çfarë tymi del nga oxhaku: i bardhë apo i zi. Dhe kjo më është kujtuar menjëherë kur kam lexuar librin. Kam verejtur, që një kulturolog, siç është Esat Ruka, është një njeriu që i referohet gjithë hapësirës natyrale shqiptare dhe, po ta shikosh në kapitullin profile krijuese, nuk ka dallesa lokale, krahinore, apo qarqesh, por ka një tërësi shtrirëse, duke evidentuar atë dashuri njerëzore e kolegjore, që është unike në mënyrën e vet.

Autori flet me të njejtën dashuri si për krijuesin e Bregut dhe atë të Veriut, si për Gjirokastrën edhe për Prishtinën, si për kulturologun në Tetovë edhe për vlerat e Malësisë së Madhe. Kjo është një gjë krejt e veçantë.

Shumë mendimtarë na porosisin që popujt kanë patur dhe do të kenë luftra mes vedit, por në kulturë asnjëherë nuk ka patur luftra. Dhe kjo evidenton shamin e fisnikërisë së kombeve e të popujve. Ne jemi një popull që të kemi qenë shumë më bujarë sesa ç'e kemi patur shtatin fizik.

Në fushëm e kulturës dhe dukurive të antropolog-

jisë kulturore kombëtare, rasti i këtij libri, mendoj se adreson një antologji të dhënash për një periudhë e cila shtrihet në dy kohë të regjimeve njerëzore që jeton shoqëria jonë. Dashuria është aqë e padalueshme si në kohën e mëparëshme aqë edhe në kohën e mëpasme. Sipas natyrës njerëzore të Esat Rukës, është e tillë që, e ruan vazhdimësinë.

Pjesa tjetër e krenarisë kulturore që ka vetë Esat Ruka, e cila buron jo vetëm nga marrëdhënia individuale e tij, për shkak të përvojës, karrierës, detyrës apo dinamikës së aktivitetit të tij, por në dy cilësi: në atë të interpretit dhe në cilësinë e humlumtësit kulturologjik. Këto janë dy aspekte që evidentohen thëllësisht në libër.

Kapitulli tjetër që flet për fenomenet kulturore Esat Ruka në këtë libër merret me parashtime e analiza, që vijnë si rezultat i marrëdhënies së individit si kulturolog me institucionalizmin shqiptar, i cili është defektos dhe një nga problemet më kryesore, keqshërbyese për trashëgiminë dhe identitetin tonë kombëtar. Ky aspekt theksohet dukshëm në libër sepse flitet për mënyrën se si institucionet duhet ta adresojnë shërbimin ndaj trashëgimisë dhe identitetit kombëtar në rapsort me gjeneratat njerëzore. Këtë gjë jo vetëm e potencon, por i mëshon në mënyrë substanciale. E fundit që dua të them është se në këtë libër ka një moment që flitet për projektimin që bëhet midis dy raporteve: kohës së sotme, e cila është e trazuar dhe e prishur atë që ne e quajmë referencat e një sistemi tradicional dhe klasik dhe sfidat që ofron kjo e sotmja në raport me trashëgiminë dhe strukturën tonë klasike dhe kulturologjike.

Në qoftë se deri dje ne me lehtësi i zhbëmë institucionet e ngritura për kulturën masive, ne sot e shohim se sa e nevojshme është për nivelin e sotëm se sa i dmd dhe jetik është për kombet e vogla ngritja e institucioneve lokale. Shembja e institucioneve lokale të kulturës është një goditje në ashtin dhe në pjesën formuese të brezëve njerëzore. Këtë gjë ne e hasim në këtë libër, madje specifikisht në dy shkrimet e fundit. Urime autorit!

**Faleminderi!**



### Studiuesi Behar Gjoka

**N**deshim shpesh në promovime të tilla që njerëit nuk janë njohur me materialin dhe parashtrimet e tij dhe jepen mendime të paadresuara. Teksa dëgjojmë mendime për librin që kemi në dorë verëhet se libri është lexuar, madje ka tërhequr vëmendjen e nevojshme për të gjykuar mbi të.

E vërteta është që libri duke iu referuar personaliteteve që merr në shqyrtim duket sikur është njohur prej kohësh, por në fakt, kur e vë përpara dhe mëson për çka autori merr përsipër, tregon se duhet kohë dhe vëmendje për ta asimiluar atë.

Ky libër, në shikimin tim ka dy momente që të heqin vëmendje: Së pari është fjala për jetën institucionale e koncertale të festivaleve, për ndikimin si artist dhe si drejtues në përditshmërinë e kësaj jete të gjallë me imtësi dhe me nervin e një profesionisti. Hera-herës ngre shqetësimin për padrejtësitë ndaj talenteve për shumë arsye, por sidomos ato politike. Shumë nga këndvështrimet antropologjike në libër dëshmojnë jo thejshëm anën administrative, por anën vizionare, atë institucionale. Autori qartëson se nuk kemi pse pretendojmë që kultura të mbijetojë pa institucione. Ka një çudi të dhimbshme, sipas meje: kur nuk kishin institucione kishim individualitete që e banin lart flamurin e shqipes, tani që kemi institucione duket sikur e shuajmë me pavëmendjes dhe pakujdesin tonë.

Pjesa më vitale e librit është ajo e profilizimit të figurave. Është hera e para që unë ndesh në një libër që i mbulon trojet etnike dhe i vështron në ndikim të figurave që kanë bërë emër. Atyre nuk u është shtuar vlera sepse i ka përmendur Esati, por sepse është kujtesa. Kjo kujtesë e figurave të mëdha si ajo e Ramadan Sokolit, një enciklopedi e gjallë sa që, por edhe

tani që uk është fizikisht, një enciklopedi e gjallë për çfarë ka lënë. Të shkosh te sinoret e muzikologjisë, të shkosh te sinoret e atdhetarisë nuk është fort e thjeshtë. Kërkohe vullnet dhe profesionalizëm.

Pavarësisht nëse biem apo jo dakort me tezat e ndonjërit, e rëndësishme është që ai vjen para nesh me opinionet e veta, strategjitë e veta, energjitë e tij krijuese. Arif Mati, një studiues interesant, i lauruar shkencërisht në Francë vjen në libër si një mësimit madh për shqiptarët, tek i cili vërshon një atdhetarizëm dhe dashuri e krenari e pa krahasueshme për origjinën, kulturën dhe ndihmesën panevropiane të të parëve tanë, por që të vërtetat e historisë së tyre janë nëpërkëmbur e tjetërsuar nga fqinjët.


Ne jemi rritur me këngën e Feride Kurtit, me rapsodinë e Qamil Gjokës, me fyellin e Imer Nelit, me muzikën e Munir Shehut, Pra ne duam, ndjejmë, dëshirojmë.

U mrekullova kur u gjeta në faqet e librit të madhin Lefter Çipa e më pas Mjeshtrin e epikës Gjokë Becin, pa harruar gjithë atë gamë të madhe individualitetesh e personalitetesh të skalitur e të qëmtuar me shumë dashuri. Ky libër është një guidë enciklopedike që na kthen vëmendjen tek sinoret e kulturës dhe trashëgimisë kombëtare, ku sejcili duhet të lërë gjurmët e veta.

Në të katër librat e Esat Rukës ndjehet shqetësimi që ti thotë gjërat hapur, troç e ndonjë herë edhe ashpër. Është shumë e rëndësishme ti thotë, ti bëjë present. Kjo llojë kahje polemizuese është shumë e nevojshme. Ne në Mat nderojmë ditën e vdekjes. Ne duhet të nderojnë jetën së pari, kontributet e gjalla dhe këtu ndjehet ai dialogu me kohën, me kulturën. Ky është një kontribut që i bën nder kulturës kombëtare, i bën nder autorit, i bën nder kujtesës. Pa kujtesë nuk kemi histori, nuk kemi fisnikëri, nuk kemi jetë të kulturuar.

Është kënaqësi të dialogosh me Esatin, me këtë kantautor, i cili për mua pas Feride Kurtit zë vëndin e merituar në muzikën e Matit me këngën popullore. Krijimtarinë, emocionin dhe dashurinë e tij ka ditur ta drejtojë e orientojë mençurisht duke e zgjeruar kulturën e Matit në frymë e në tinguj, duke e rritur atë në horizontet e reja arbënore, aty ku i thuhet ujit-ujë e bukës bukë.

**Ju faleminderit!**



## Ing. Mark Palnikaj: Studiues i Historisë

**M**egjithëse tropojan dhe jashtë fushës së objektit të librit të sapobotuar dua të shpreh vlerësimin tim për autorin Esat Ruka, i cili është miku im i respektuar. Sigurisht jam impresionuar nga mendimet e parafolësve specialistë dhe pajtohem plotësisht me to, pasi unë njoh krijimtarinë muzikore të Esatit. Këngët e tij, jo vetëm i dëgjoj me ëndje, por i shpërndajë ndër miq të mi. Jam adhures dhe ndjekës i folklorit tonë të mrekullueshëm. Desha të theksoj se si studiues i arkivave, jam i afektuar me dokumentacionin që kam hasur për historinë dhe kulturën e Matit dhe jam dashuruar me të. Nëse Esati ka bërë një punë shembullore, shembulli i tij duhet ndjekur edhe nga specialistë të fushave të tjera. Mati duhet të marrë vendin që meriton në analet e historisë kombëtare. Pesë botime janë bërë për Historinë e Shqipërisë dhe Mati thuajse nuk përmendet. Vetë matjanët duhet të eksplorojnë dhe botojnë për të vënë në vend kontributin e madh historic e kulturor të të parëve të tyre.

Faleminderit.

## Mesazhi i Dritan F. Haxhia, Kryetar i Unionit të gazetarëve në SHBA

*Dashur artist i nderuar Esat Ruka, mik i babës dhe i familjes tonë. Të uroj shumë suksese në botimin e librit të ri. Është nder për ne dhe brezin tonë, që patën fatin e madh që të jemi bashkudhëtarë të kontributit tuaj artistik për shumë e shumë vite me radhë. Ju mbeteni njëri nga ata artistë, që me talentin tuaj shkruani nota muzikore e vargje të arta për vazhdimësinë folklorike e artistike për kulturën burimore të vendit tonë e më gjërë. Respekte e mirënjohje. Me dashuri e përqafime*



## Mimoza D. Kurti, Profesore e Gjuhës Shqipe.

**E**sat Ruka është një personalitet i njohur i Matit për vlerat krijuese e interpretuese dhe qytetare që ruan. Në këtë libër, për mua, ai ka shpalosur një gjënjalitë duke portretizuar thellë ndjesitë jo vetëm profesionale, por mbi të gjitha njerëzore të shumë personaliteteve të kulturës kombëtare me dashuri e profesionalizëm.

Unë dua të falenderoj me zemër për përshkrimin njerëzor që ka bërë për babain tim studiuesin Dilaver Kurti. Familja jonë i është mirënjohëse gjithmonë.

Esati na thotë "Mos e ndani zemrën prej Matit" dhe unë jam krenare që jam matjane.

Njatzeta Esat Ruka.





**Haziz Celami**

E njoh Esat Rukën si bashkëmohatar e -ish nëpunës në Komitetin Ekzekutiv të Matit. Një djalë elegant e i qeshur, i dashur e me synime profesionale të gjëra. Esati ka qenë gjithmonë demokrat e me zemër të madhe. Ai, edhe sot, na nderon si gjithnjë duke na mbledhur e krenuar si matjanë....




(Shfaqet në monitor një përshëndetje emocionuese, ku vajza e autorit me adhurim nderon babain e saj për punën që ka bërë dhe gjurmët që ka lënë si artist, drejtues e studiues.) Të pranishmit e shoqërojnë videomesazhin me duartrokitje.



### **Desada Gjetani: Studente e Fakultetit Histori-Filologji, Tiranë**


Ishte kënaqësi për mua të jemë në këtë institucion prestigjioz për herë të parë në promovimin e librit të bashkëqytetarit tonë të nderuar Esat Ruka. Faleminderit që më bëtë pjesë të auditorit. Kam ardhur me 10 shoqe të cilat duan të njihen me librin e autorit, por edhe me gjykimet e personaliteteve të fushës. Sot kam një surprizë të bukur, të cilën ma ka besuar vajza e tij Blerina nga diaspora e Kanadasë. Le të ndjekim së bashku në videoprojektor një mesazh përshëndetës për autorin e librit.





## VLERËSIMET DHE IDE TË SPECIALISTËVE TË KULTURËS PËR LIBRIN

*Autori falenderon miqtë e tij, studiues e veprimtarë, artistë e kolegë!*



**K**ur vendosa të përfshijë në këtë libër shkrime të mia të një hapësire kohore prej 15 vitesh, brenda meje buçiste një zë i brendshëm qytetar e profesional, për të përbushur atë angazhim që më ka shoqëruar gjatë gjithë karrierës time. Fati më ka priurë, që të bashkëpunoj me personalitete të larta të artit e kulturës shqiptare, miq e simpatizantë të trashëgimisë së popullit tonë. I ushqyer nga dashuria dhe pasioni për artin dhe traditat e kombit tim, i magjepsur nga bukuria, larmia, thellësia e mendimit dhe shija e hollë e njerëzve nga hapësirat mbarëshqiptare, i mrekulluar nga puna, talenti e përkushtimi i dhjetra mendimtarëve e profesionistëve e mijëra bardëve e artistëve, u ula në studion time të punës për të lënë të shkruar në letër disa nga dukuritë e Etnosit tone. Sigurisht, nuk kam operuar në rrugë të pashkelura nga shumë prej studiuesve shqiptarë dhe të huaj në lëmitë e kulturës dhe të artit. Jam konsultuar me një literaturë të gjërë, ashtu sikundër u jam referuar së pari kontakteve fizike e më pas gjurmimeve e studimeve, analizave, opinioneve e veprimtarive garuese të arkivuara nga përvoja ime e punës drejtuese.

Me sinqeritet e pohoj se, më ka mundur thellë dhe gjatë dëshira dhe përgjegjësia për t'ua qëndisur vërtetësisht, gjithshka ata meritojnë, për t'i paraqitur para lexuesit madhështorë, siç edhe janë.

Nëpërmjet parashtrimeve, opinioneve, analizave dhe nderimit për emrat e shquar që, gurët e pengesave i kthyen në shkallë suksesi, shpresoj të kem prekur konkretisht në ashtin e angazhimit të tyre, të cilët kanë provuar pagjumësinë dhe intensitetin e lartë të impenjimit mendor e emocional, duke shijuar edhe kënaqësinë, që të dhuron duartokitja e zjarrtë, fjala e ëmbël e urimi i ngrohtë.

Në këtë libër, edhe midis rreshtave, zë vend pezmi i shumë prej emrave, që nuk u lejuan ta shpërfaqin të plotë kumtin e tyre artistik për shkaqe të diferencimit politik. Ky lëndim për disa individë mendoj se duhet t'i bëjë të prekshëm edhe drejtuesit e institucioneve speciale të kulturës. Opinioni i shëndetshëm duhet të kuptojë dhe të reagojë me



vetëdije se, janë virtytet, ato që i bëjnë artistët më të prekshëm.

\*\*\*\*\*

*Libri "Dukuri, Fenomene kulturore, Profile krijuese" u botua nga Arte Graphic dhe doli nga shtypi në qershor 2023. Kisha projektuar të bëhej pjesë e tryezës së Festivalit Kombëtar në Gjirokastrë 2023. Nuk ndodhi për shkak se u tha që në ditët e festivalit nuk do të ketë veprimtari promovuese dhe as tryezë diskutimesh, madje as Juri vlerësimi për prurjet dhe interpretimet folklorike. U mendua midis miqësh të bëhet në muajin tetor- muaji i letërsisë.*

Dhe kështu u realizua në Prizren, në Mat dhe në Tiranë. Për organizimin e përirimit të këtij libri u aktivizuan një numër i konsiderueshëm drejtuesish të Shoqërive kulturore, specialistësh e personalitetesh të kulturës shqiptare, të cilët me fjalën e tyre të mençur hodhën dritë mbi parashtrimet, evidentuan vlerat ideore, estetike e përmbytësore të tij. Diskutantët ishin të një mendimi se korpusit të madh të botimeve për etnokulturën shqiptare i shtohet edhe ky libër studimor me veçanësitë e tij të prurjeve, me analizat e opinionet me vështrim e përkushtim profesional e atdhetar.

Libri "Dukuri, Fenomene kulturore, profile krijuese" duhet të jetë në tryezën e specialistëve e studentëve, artistëve e studiuesve, drejtuesve të institucioneve të vendit dhe lexuesit të zakonshëm. Realizimit të përirimit të tij i shërbyen me dashuri miqtë e autorit për dokumentimin e tij si reporterë e fotografë, gazetarë e grafistë e artistë.

I falenderoj të gjithë më përulësi, duke premtuar në vazhdimësinë e punës time krijuese.

Libri gjer në fillim të nëntorit 2023 gjendet në bibliotekat publike: "P. Bogdani"-Prishtinë, "S. Krasniqi" Rahovec, Suharekë, Vushtrisë, "I. Rugova"- Gjakovë, Prizren, biblioteka e shkollës së Muzikës Prizren, Kukës, Rrëshen, Lezhë, Kurbin, Mat, Tiranë, Shpërndarja vazhdon...

*Libri tregëtohet në "ART'S" Bulevardi ZOGU I-Tiranë, dhe Libraria e Universitetit- Tiranë*